

KOSOVO POLICE

MBROJTËSI

Vëllimi IX - Nr. 2 ... drejtësi për të gjithë



PËRKUJTOHET HEROI I KOSOVËS ENVER ZYMBERI

Me homazhe tek varri, vizita te familja dhe me një akademi përkujtimore, u kujtua dhe u nderua në dyvjetorin e rënies, pjesëtari i Njësisë Speciale Operative të Policisë së Kosovës, Enver Zymeri

FAQE 16-17 >>



14 VJET ME POLICINË E KOSOVËS

Në një ceremoni solemne Policia e Kosovës ka shënuar 14 vjetorin e formimit të saj

FAQE 14-16 >>



POLICIA E UDHËHEQUR NGA INTELIGJENCA

Intervistë me z. Naim Rexha, zëvendësdirjtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës

FAQE 8-10 >>



POLICËT E ARDHSHEM

FAQE 24-25 >>

Një vit i mbarë

Viti që lamë pas ishte mjaft i suksesshëm për Policinë e Kosovës. Këto suksese filloi së numëruari që nga operacionet policore të suksesshme, sidomos në fushën e luftimit të veprave penale të krimit të organizuar, si: konfiskimi i substancave narkotike, trafikimi me qenie njerëzore, krimet ekonomike, kontrabandë me migrantë dhe parandalimi dhe trajtimi i të gjitha rasteve, nga njësitë patrulluese në terren i të gjitha dukurive negative që bien në domenin e fushëveprimit të Policisë së Kosovës.

Zyrtarët policorë në të gjitha nivelet gjatë këtij viti, përveç parandalimit, kanë realizuar edhe mjaft operacione policore që kanë rezultuar me arrestimin e shumë personave të përfshirë në vepra penale, duke ngritur zbulueshmërinë e rasteve dhe çorganizimin e grupeve kriminale që kanë vepruar.

Një nga të arriturat e Policisë gjatë vitit që lamë pas dhe që vazhdoi edhe këtë vit është se PK-së iu shtuan edhe zyrtarë policorë të rinj të cilët sollën energji dhe freski të re punuese që vërehet në terren anë e kënd kryeqytetit. Puna e këtyre ekipeve nëpër rrugët e kryeqytetit është vërejtur dhe vlerësuar shumë nga qytetarët përmes komenteve shumë pozitive si për qasjen shumë profesionale në punë por edhe për dukjen e tyre pedante dhe profesionale.

Po ashtu edhe pas një kohe relativisht të gjatë me një vendim të drejtorit të Përgjithshëm të PK-së z. Shpend Maxhuni, një vit më parë filloi edhe procesi i gradimit për pjesëtarët e Policisë së Kosovës, duke filluar nga gradat e larta: nënkolonel dhe deri në gradën rreshter, proces që është në vazhdim e sipër.

Motivi për avancim që është nevojë njerëzore e gjithsecilit njeri, jo vetëm e pjesëtarëve të Policisë, por në rastin konkret, dëshira për zhvillimin e një karriere të suksesshme brenda Policisë së Kosovës, bëri që një numër i konsiderueshëm i zyrtarëve policorë të PK-së të dalin nga rutina dhe t'i rreken punës së leximit dhe studimit, jo pse më herët s'kishin bërë një gjë të tillë por kishin për qëllim përgatitjen për fazat e testimit për gradat e aspiruara në mënyrë që të dalin sa më suksesshëm dhe të arrijnë qëllimin final.

Fundi i vitit 2012 erdhi me përfundimin e procesit për gradat nënkolonel, ndërsa tremujori i parë i këtij viti me gradat major dhe kapiten për të vazhduar me procesin për gradat tjera: toger dhe rreshter, procese që marrin pak më shumë kohë për shkak të numrit më të madh të kandidatëve që u nënshtrohen testeve.

Organizimi i gjithë këtij procesi kërkon punë dhe angazhim për Drejtorinë për Menaxhimin e Karrierës dhe Performancës së PK-së, që pa dyshim një meritë për mirëvajtjen e këtij procesi u takon atyre.

Këtë vit PK-ja feston 14 vjetorin e krijimit edhe pse si numër është vetëm dyshifror dhe mund të duket pak por PK-ja tashmë ka krijuar identitetin e saj si organizatë profesionale dhe e denjë për të kryer detyrat dhe misionin e saj.

Pa dyshim që edhe përkundër të arriturave deri më tani vlen të thuhet se ne zyrtarët policorë që kemi vendosur që jetën, punën dhe karrierën tonë ta kalojmë në uniformën e Policisë së Republikës së Kosovës duhet që me punë dhe përkushtim të vazhdueshëm ta ruajmë dhe ta ngrijmë besimin që qytetarët e vendit na e kanë dhënë gjatë këtyre viteve dhe t'ua kthejmë me shërbim sa më kualitativ, gjithmonë në shërbim të tyre.



Brahim Sadriu



Revistë e Policisë së Kosovës

Redaktor:

Brahim Sadriu

Botues:

ZIMP

Zyra për Informim dhe Marrëdhënie
me Publikun e PK-së
DPP - Prishtinë

Tel.: 038 5080 1237

Mob.: 045 266 252

E-mail:

brahim.sadriu@kosovopolic.com

braimsadriu@gmail.com

Bashkëpunorë:

Baki Kelani

Mërgim Bekteshi

Avdyl Kadria

Dizajni:

Çajup Kajtazi

Fotograf:

Arbër Muhadri

Lektor:

Leonora Fejzullahu - Ruhani

VSAT: 1145/1046

çajup.kajtazi@kosovopolic.com

webmaster@kosovopolic.com

www.kosovopolic.com

DONACION PËR PK-NË

Donacion për Policinë e Kosovës nga EULEX-i

4-5

POLICIA KUFITARE - PERËNDIMI

Avancon në punën e saj

6-7

POLICIA E UDHËHEQUR NGA INTELIGJENCA

Intervistë me z. Naim Rexha, zëvendës drejtor i PK-së

8-10

KONFERENCË POLICI - MEDIA

Për një informim më të mirë dhe të drejtë të qytetarëve

11-12

14 VJET ME POLICINË E KOSOVËS

Ceremonia e kremtimit të 14 vjetorit të themelimit të PK-së

13-15

PATRULLIM I PËRBASHKËT

Nënshkruhet marrëveshja për patrullim të përbashkët gjatë sezonit veror

14-15

HEROI ENVER ZYMBERI

Përkujtohet heroi i Kosovës Enver Zyberi

16-17

PUNA E NJË POLICI NË PATRULLË

Përbën shpirtin komunikues në mes të policit dhe qytetarit

18-19

OPERACIONE

Departamenti për Hetimin e Krimit

22-23

KURIOZITETE

26 - 27

FOTOLAJM

28

MË GJERËSISHT →

PIKË SHITESË:

Mendimet, komentet, këndvështrimet e shprehura ose të përfshira në përmbajtje të këtij botimi nuk paraqesin medeomos politikat ose vështrimet zyrtare të PK-së



DONACION PËR POLICINË E KOSOVËS NGA EULEX-i

Në këtë ceremoni ishin të pranishëm Bernd Borchardt, shef i misionit të EULEX-it, z. Shpend Maxhuni, drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Nenad Djuric, u.d. komandant rajonal për veriun.

Duke shprehur kënaqësinë e tij për ndihmën që po i ofron Policisë së Kosovës në fjalimin e tij shefi i misionit të EULEX-it, Bernd Borchardt tha: "Jam i lumtur që po ia dorëzoj çelësat e këtyre automjeteve Policisë së Kosovës sot. Kjo është shenjë edhe për zvogëlimin e EULEX-it por edhe për rritjen e Policisë së Kosovës. Tani, 23 këshilltarë të EULEX-it janë duke punuar në mbështetjen e ekipit të sapoformuar të Komandës Rajonale (Veri) dhe unë kam besim të plotë që ata do të punojnë së bashku për ta themeluar një shërbim të fuqishëm dhe përgjegjës policor për

Në një ceremoni solemne që është mbajtur me 16 shtator 2013 në stacionin e Policisë së Kosovës në pjesën veriore të Mitrovicës, EULEX-i ia ka dhuruar Policisë së Kosovës 22 automjete dhe pajisje për zyrë si donacion për 'Drejtorinë e sapoformuar të Policisë Rajonale (Veri)'

komunitetin lokal këtu në veri të Kosovës".

Ndërsa drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, z. Shpend Maxhuni, duke falënderuar EULEX-in, ka thënë që ky donacion do të kontribuojë në mënyrë të konsiderueshme për përmirësimin e efikasitetit të punës së Policisë së Kosovës në veri.

"Shfrytëzoj rastin të falënderoj EULEX-in për mbështetjen e vazhdueshme që është duke i dhënë Policisë së Kosovës, dhe ky donacion do të jetë një ndihmë e madhe e cila do të kontribuojë në ngritjen e efektivitetit dhe efikasitetit të Drejtorisë Rajonale të Policisë në veri të Mitrovicës. Duke shfrytëzuar në mënyrë proaktive këto vetura të dhuruara nga EULEX-i, Policia e Kosovës do të shtojë performancën duke ofruar shërbime policore më kualitative



karshi qytetarëve të pjesës veriore”, tha Maxhuni.

Ndërsa ushtruesi i detyrës së komandantit regional z. Djuric zyrtarët policorë që janë nën mbikëqyrjen e të cilit do t’i përdorin këto vetura gjatë punës policore falënderoi EULEX-in, duke

thënë: “Veturat e dhuruara do të përdoren për të përmirësuar sundimin e ligjit dhe efkasitetin tonë në veri, gjë e cila do të rezultojë në siguri dhe rend për të gjithë qytetarët që jetojnë në veri. Qëllimi ynë kryesor është përmirësimi i sigurisë për të gjithë qytetarët, dhe në të

ardhmen ne do të përpiqemi ta sjellim atë në nivelin më të lartë”, tha Djuric. Në këtë ceremoni të dhënies së donacionit kanë marrë pjesë edhe zyrtarë të lartë si nga Policia e Kosovës, EULEX-it, si dhe përfaqësues të mediave.

Përgatiti: Brahim Sadriu





DREJTORIA RAJONALE E POLICISË KUFITAR

Nënshkrimi i marrëveshjeve të mirëkuptimit dhe protokolleve të bashkëpunimit me policitë e shteteve fqinje, Shqipërinë, Malin e Zi dhe Maqedoninë, në fusha të ndryshme të aktiviteteve të përbashkëta në funksion të luftës kundër krimit ndërkufitar, i cili gjithsesi lidhet me krimin e organizuar, e ka ngritur sigurinë e përgjithshme në kufijtë e përbashkët.

Këtyre ditëve, gjegjësisht me 1.7.2013

Policia e Kosovës në përgjithësi Policia Kufitare, në kuadër të PK-së në veçanti, për çdo ditë e më shumë janë duke i përmbushur kërkesat për plotësimin e standardeve më të larta të vendeve të zhvilluara demokratike, sidomos në lëmin e menaxhimit të integruar të kufirit



ka filluar së zbatuari në praktikë protokollin për sistemin "kontrolli në hyrje" në dy pikat e kontrollit kufitar, Qafë Morinë dhe Qafë Prush, praktikë kjo e cila është në zbatim në PKK Vërmicë që nga vera e vitit 2011. Me këtë të gjitha pikat e kontrollit kufitar me Republikën e Shqipërisë, PKK Vërmicë, PKK Qafa e Prushit dhe PKK Qafa e Morinës janë duke punuar me sistemin "kontrolli në hyrje" me të cilin sistem bëhet kontrolli vetëm në hyrje të secilit shtet. Ky sistem nuk e ndalon apo kufizon edhe kontrollin në dalje i cili mund të zbatohet në çdo kohë me metodën e profilizimit, kur analiza dhe vlerësimi i rrezikut e parashohin të nevojshme dhe të domosdoshme. Nga përvoja e deritashme



RE "PERËNDIMI" AVANCON NË PUNËN E SAJ

ky sistem ka përparësi të madhe në evitim të radhëve dhe pritjeve të gjata sidomos në sezonin e verës kur qarkullimi, sidomos në PKK Vërmicë, është enorm.

Me datën 16.6.2013 në stacionin e pikës së kontrollit kufitar në Vërmicë, në bazë të protokollit për bashkëpunim me policinë kufitare të Republikës së Shqipërisë, ka filluar së funksionalizuar Qendra e Përbashkët e Bashkëpunimit dhe Shkëmbimit të Informatave. Kjo qendër ka karakterin e një zyre koordinuese në shkëmbimin sa më të shpejtë dhe të besueshëm të informatave relevante në luftën e përbashkët kundër krimit ndërkufitar, por edhe të bashkëpunimit në të gjitha fushat me interes të përbashkët.

Në zonën e kufirit me Republikën e Shqipërisë janë edhe tre pika të përkohshme të kontrollit kufitar, Shishtavec-Shishtavec, Gllloboçicë-Borje dhe Orçushë-Orgjost. Këto tri pika shërbejnë për kalim të kufirit të banorëve të vendbanimeve nga të dyja anët e brezit kufitar në orar të caktuar. Pas Shishtavecit që nga data 26.6.2013 edhe dy pikat tjera Gllloboçicë-Borje dhe Orçushë-Orgjost janë të përbashkëta, që do të thotë punohet në objekte



te të përbashkëta dhe kryhet kontrolli i përbashkët (që të tre janë në territorin e Republikës Shqipërisë).

Me datën 25.6.2013 është mbajtur në Pejë takimi i përbashkët i grupeve të demarkacionit me Malin e Zi. Pritjet janë që gjatë këtij viti të përfundojë ky proces.

Aktivitetet e përbashkëta me policinë kufitare të shteteve fqinje kanë vazhduar, duke u intensifikuar edhe gjatë

këtij viti. Me Republikën e Shqipërisë dhe Maqedonisë, bazuar në protokollet e bashkëpunimit është shtuar numri i patrullimeve të përbashkëta, ndërsa me Malin e Zi deri në një marrëveshje tjetër është vazhduar me patrullime të sinkronizuara. Më poshtë janë disa ilustrime të aktiviteteve të përbashkëta me policinë kufitare të Republikës së Shqipërisë.

Përgatiti: Avdyll Kadria



Intervistë me z. Naim Rexha, zëvendësrektor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës

POLICIA E UDHËHEQUR NGA INTELIGJENCA

Mbrojtësi: Jeni caktuar nga drejtori i përgjithshëm, koordinator për implementimin e strategjisë “Policimi i Udhëhequr nga Inteligjenca”, a mund t’i cekni disa prej aktiviteteve të rëndësishme që janë zhvilluar që nga fillimi i implementimit të kësaj strategjie?

Naim Rexha: Strategjia “Policimi i Udhëhequr nga Inteligjenca”, (PUI) ka për qëllim që të krijojë një metodologji moderne të policimit, që do t’i mundësojë Policisë së Kosovës qasje pro-aktive ndaj problemit dhe ngritjen

Strategjia “Policimi i Udhëhequr nga Inteligjenca”, i ka mundësuar Policisë së Kosovës shfrytëzimin e burimeve të saj në mënyrë efikase dhe efektive përmes aplikimit të metodologjisë moderne të policimit, duke mundësuar marrjen e vendimeve, bazuar në produktet e inteligjencës

e efikasitetit në kryerjen e detyrave policore. Me zbatimin e kësaj strategjie dhe planit të veprimit synohet që në Policinë e Kosovës të fuqizohet aplikimi i modelit “Policimi i udhëhequr nga Inteligjenca”.

Konform dinamikës së implementimit deri më tani janë zhvilluar aktivitetet e parapara sipas kohës së përcaktuar me plan të veprimit, të cilat janë:

- Është bërë rishikimi dhe plotësimi i kriterëve për rekrutim të personelit të angazhuar drejtpërdrejt në detyra të inteligjencës.
- Rishikimi dhe plotësimi i përshkrimeve

të vendeve të punës për zyrtarët policorë të inteligjencës.

•Identifikimi i nevojave për trajnim dhe janë certifikuar 11 trajner të Inteligjencës.

•Drejtoria për bashkëpunim ndërkombëtar në fushën e zbatimit të ligjit ka mbajtur takime të përbashkëta të rregullta me institucionet e tjera.

•Sa i përket fuqizimit të bashkëpunimit me qytetarë dhe shoqërinë civile, në të gjitha takimet e mbajtura të KKS-së nëpër komunat e Kosovës kanë marrë pjesë komandantët e stacioneve siç është e përcaktuar edhe me Udhëzimin Administrativ.

•Ndërsa kur flasim për bashkëpunimin me shoqërinë civile janë organizuar takime me OJQ, të cilat merren me studimin dhe trajtimin e problemeve në fushën e sigurisë.

•Takime me institucione arsimore gjithmonë në funksion të fuqizimit dhe implementimit të kësaj strategjie.

‘Mbrotjtësi’: Duke qenë se tashmë ka më shumë se dy vjet që PK-ja ka filluar ta zbatojë këtë strategji, a janë hartuar procedurat standarde të veprimit lidhur me implementimin e kësaj strategjie dhe a mund të cekni disa prej tyre?

Naim Rexha: Po, janë hartuar Procedura Standarde të Veprimit (PSV) lidhur me implementimin e kësaj strategjie. Gjithashtu me qëllim të implementimit të strategjisë së PUI-së është bërë modifikimi i të gjitha PSV-ve aktuale në nivel të të gjitha departamenteve të PK-së.

‘Mbrotjtësi’: Përmendët trajnimet e zyrtarëve policorë për implementimin e këtij modeli të policimit, çfarë trajnimesh janë realizuar dhe çka planifikohet në këtë drejtim në të ardhmen?

Naim Rexha: Gjatë periudhës Prill-Qershor të këtij viti janë mbajtur katër trajnime dhe janë trajnuar 65 zyrtarë duke përfshirë edhe trajnerët. Trajnimet e mbajtura kanë qenë të fokusuara në fushën e policimit të udhëhequr nga intelijenca, ndërkurset mbajtura janë: kursi analiza e inteligjencës kriminale,



trajnimi i avancuar mbi analizën e inteligjencës kriminale dhe krijimin e bazës për analizën e inteligjencës kriminale, trajnimi për vlerësimin e rreziqeve, motivet dhe përkrahja psikologjike e informatorëve si dhe trajnimi për trajnerët e inteligjencës.

‘Mbrotjtësi’: Kjo është strategjia e dytë pas skadimit të afatit të strategjisë së parë, Policimi i Udhëhequr nga Intelijenca, cilat janë sfidat, problemet që keni hasur në implementim, duke qenë se kjo ka qenë risi për Policinë e Kosovës?

Naim Rexha: Natyrisht se implementimi injë modelit të ri policor në çdo organizatë ka vështirësi dhe sfida fillestare por deri më tani kemi arritur që të menaxhojmë me sukses vështirësitë e hasura dhe të realizojmë aktivitetet tona konform planit të veprimit.

Është sfida në vete implementimi praktik i procesit të inteligjencës, pasi që kjo filozofi e re policore kërkon qasje të re në punën policore dhe adaptim të stafit policor në këtë metodologji.

Si rezultat i strategjisë së PUI-së dhe trajnimeve të mbajtura, zyrtarët policorë gradualisht janë adaptuar me këtë filozofi policore. Përmes trajnimeve dhe takimeve të mbajtura në nivele të ndryshme në kuadër të PK-së është arritur që të qartësohet tek zyrtarët

policorë se zhvillimi dhe zbatimi i sistemit unik dhe të qëndrueshëm të inteligjencës policore është i domosdoshëm.

Strategjia “Policimi i Udhëhequr nga Intelijenca”, i ka mundësuar Policisë së Kosovës shfrytëzimin e burimeve të saj në mënyrë efikase dhe efektive përmes aplikimit të metodologjisë moderne të policimit, duke mundësuar marrjen e vendimeve, bazuar në produktet e inteligjencës.

‘Mbrotjtësi’: Një pyetje sa i përket trendit të kriminalitetit dhe çështjes së reduktimit të frikës nga krimi. Problematikë që ka qenë në shumicën e policive kur u kanë hyrë këtyre reformave ka qenë se trendi i kriminalitetit është rritur, mirëpo hulumtime të ndryshme kanë treguar se frika nga krimi është reduktuar. A jeni duke e përcjellë çështjen e trendit të kriminalitetit, frikës nga krimi apo kohën e reagimit që ka filluar implementimi i kësaj strategjie, sa ka efekt në hetimin e rasteve që raportohen?

Naim Rexha: Policia e Kosovës gjatë hartimit të këtij dokumenti dhe planit të veprimit, i ka kushtuar vëmendje të veçantë mekanizmat e implementimit të saj, që janë të ndërlidhura shumë ngushtë me modelin “Policimi në



Bashkësi", duke u fokusuar edhe në përfshirjen e brengave të komunitetit në caktimin e prioriteteve të Policisë, me qëllim të krijimit të një ambienti sa më të sigurt për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

Vazhdimi i zbatimit të këtij modeli do t'i mundësojë Policisë së Kosovës të aplikojë metoda adekuate të policimit, qasje proaktive, planifikim dhe menaxhim efikas të resurseve dhe organizim më të mirë të punës. Kalimi nga qasja reaktive në qasjen proaktive të luftimit të krimit dhe shndërrimi i informatave të inteligjencës në inteligjencë formuese ka dhënë rezultate të cilat kanë ndikuar në uljen e frikës nga krimi, rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit në parandalimin dhe hetimin e rasteve kriminale.

'Mbrotjtësi': Policimi i Udhëhequr nga Inteligjenca ka mision, detyrë mbledhjen e informatave nga terreni, analizimin nga sektori përkatës dhe shpërndarja e këtyre

informatave tek njësi policor që kanë për detyrë parandalimin apo hetimin e kriminalitetit. Sa ndikon kjo qasje në rritjen e bashkëpunimit të brendshëm në mes të njësive dhe sektorëve të PK-së?

Naim Rexha: Strategjia Policimi i Udhëhequr nga Inteligjenca dhe plani i veprimit të kësaj strategjie, është e dizajnuar në atë mënyrë që të mundësojë funksionalizimin e plotë të procesit të inteligjencës në të gjitha nivelet e organizimit, duke mundësuar përfshirjen e të gjithë punonjësve të PK-së në këtë proces. Ky proces ka për synim përmbushjen e misionit të Policisë së Kosovës dhe synimeve strategjike që dalin nga "Plani Strategjik Zhvillimor" i PK-së dhe dokumenteve të tjera strategjike (nacionale dhe sektoriale) përmes fuqizimit të kapaciteteve në kuadër të Policisë së Kosovës, avancimit të sistemeve të teknologjisë informative dhe komunikimit, fuqizimit të bashkëpunimit dhe koordinimit, si dhe aktiviteteve tjera praktike të

domosdoshme për funksionalizimin e tërësishëm të këtij procesi. Mbledhja e informatave nga terreni, analizimi nga sektori përkatës dhe distribuimi i këtyre informatave tek njësi policor që kanë për detyrë parandalimin apo hetimin e kriminalitetit, rezultojnë në rritjen e bashkëpunimit të brendshëm në mes të njësive dhe sektorëve të PK-së.

'Mbrotjtësi': Cili do të ishte mesazhi juaj për të gjithë zyrtarë policorë lidhur me Strategjinë e Udhëhequr nga Inteligjenca?

Naim Rexha: Ftoj dhe inkurajoj të gjithë zyrtarët policorë pa dallim grade që të japin kontributin e tyre me qëllim të implementimit të strategjisë "Policimi i Udhëhequr nga Inteligjenca". Këtë kontribut ata mund ta japin duke bashkëpunuar me zyrtarët policorë të Inteligjencës në aspektin e dhënies së informatave, shkuarjen e raporteve inteligjente dhe procedimin e tyre tek njësitet përkatëse.

Intervistoi: Brahim Sadriu

PËR NJË INFORMIM MË TË MIRË DHE TË DREJTË TË QYTETARËVE

Në konferencën dyditore me temën “Përmirësimi i informimit të banorëve të Kosovës përmes mediave mbi çështjet e sigurisë”, me përfaqësuesit e policisë dhe të mediave, janë pajtuar ta intensifikojnë bashkëpunimin në mes tyre, me qëllim që qytetarët të jenë të informuar drejt dhe saktë për aktivitetet e Policisë dhe gjendjen e sigurisë

Në konferencën dyditore me temën “Përmirësimi i informimit të banorëve të Kosovës përmes mediave mbi çështjet e sigurisë”, me përfaqësuesit e policisë dhe të mediave, janë pajtuar ta intensifikojnë bashkëpunimin në mes tyre, me qëllim që qytetarët të jenë të informuar drejt dhe saktë për aktivitetet e Policisë dhe gjendjen e sigurisë.

Me qëllim të ngritjes së bashkëpunimit dhe diskutimin e praktikave për bashkëpunim polici-mediash në Kosovë, Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim Rajonal (OSBE), në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, ka organizuar një konferencë dyditore, ku kanë marrë pjesë zyrtarë policorë nga departamente të ndryshme të Policisë së Kosovës, përfaqësues të OSBE-së, përfaqësuesit e mediave, Inspektorati Policor i Kosovës (IPK), Akademia e Kosovës

për Siguri Publike (AKSP) dhe ICITAP-i, e cila është mbajtur në Prizren nga datat 19 deri 21 shtator 2013.

Në hapje të konferencës në fjalën hyrëse Naim Rexha, zëvendës drejtor i Policisë së Kosovës, duke iu referuar disa ngjarjeve që lidhen me Policinë e Kosovës, ka kërkuar nga mediat të jenë korrekt gjatë raportimeve për incidente të caktuara. Në këtë kontekst, z. Rexha ka theksuar se “ka hapësirë për bashkëpunim më të mirë në mes të mediave dhe Policisë së Kosovës duke u sugjeruar mediave që t’i prezantojnë edhe sukseset e Policisë së Kosovës në luftimin e të gjitha dukurive negative dhe kriminale, me qëllim krijimin e perceptimit pozitiv tek qytetarët për punën e Policisë. Pas ngritjes së disa shqetësimeve nga ana e përfaqësuesve të mediave lokale lidhur me vështirësitë e komunikimit me zyrat

rajonale për informim brenda Policisë së Kosovës, z. Rexha është zotuar se këto ngarkesa në komunikimin polici-media do të eliminohen gjithmonë në funksion të informimit sa më të drejtë e korrekt të qytetarëve.

Znj. Shpresa Mulliqi, përfaqësuese e OSBE-së dhe një nga organizatorët e kësaj konference, duke vlerësuar praninë e mediave dhe zyrtarëve policorë në këtë konferencë dhe gatishmërinë për të diskutuar së bashku dhe për të gjetur praktikatat më të mira të bashkëpunimit, ka thënë se “është e domosdoshme të ketë bashkëpunim më të avancuar në mes të mediave dhe Policisë së Kosovës”. Sipas znj. Mulliqi, avancimi i këtyre raporteve do të ndikojë pozitivisht në informim të drejtë dhe të saktë nga ana e mediave për çdo aktivitet të Policisë së Kosovës





për përmirësimin e ambientit të sigurisë, duke shprehur gatishmërinë që edhe në të ardhmen OSBE-ja do të vazhdojë të luajë rol aktiv në fushën e sigurisë dhe se do të jetë partnere serioze me mediat e shkruara dhe elektronike. Përfaqësuesi i Unionit të Gazetarëve të Kosovës (UGJK), z. Lulzim Ahmeti i cili ka thënë se ka hapësirë për thellim të bashkëpunimit ndërmjet Policisë së Kosovës dhe mediave, ka kërkuar nga Zyra për Informim e Policisë së Kosovës të jetë më efikase në konfirmimin e informacioneve, në mënyrë që t'u shmangemi keqkuptimeve dhe dezinformimeve të ndryshme.

Nga ana e Policisë së Kosovës në këtë konferencë janë bërë disa prezantime në mënyrë që mediat të informohen për punën e njërive policore, siç janë njësitet speciale, komunikacioni ruqor dhe nga Departamenti i Hetimeve. Në përmbledhje të aktiviteteve të kësaj konference të gjithë pjesëmarrësit kanë arritur në përfundim se takime të tilla janë më se të nevojshme të organizohen edhe në të ardhmen. Organizimi i takimeve të tilla ndikon në njohjen e punës së secilit institucion pjesëmarrës dhe në krijimin e raporteve ndërnjerëzore që janë të domosdoshme në efikasitetin e punës me publikun. Takime të tilla po ashtu mundësojnë evidentimin e lëshimeve eventuale gjatë punës së policisë dhe mediave.

Përgatiti: Brahim Sadriu





14

VJET ME POLICINË E KOSOVËS

Në një ceremoni solemne Policia e Kosovës ka shënuar 14 vjetorin e formimit të saj, ku gjatë diskutimeve u vlerësua lart puna dhe angazhimi i të gjithë pjesëtarëve të policisë gjatë këtyre vjetëve, për ngritjen e kësaj organizate jetike për vendin, për vendosjen e zbatimin të rendit, ligjit dhe luftimin e krimit të organizuar

Me rastin e përvjetorit të themelimit të Policisë së Kosovës edhe këtë vit me 6 shtator 2013 u organizua një ceremoni solemne që u mbajt në "Sallën e Kuqe" të Pallatit të Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë, me qëllim kremtimin e kësaj dite, që njihet në Kosovë edhe si Dita e Policisë së Kosovës. Në këtë ceremoni që është organi-

zuar nga Policia e Kosovës morën pjesë përfaqësues të lartë të vendit dhe nga kori diplomatik i akredituar në Kosovë si dhe institucione ndërkombëtare që janë me mision në Kosovë dhe familjarë të policëve të vrarë në kryerje të detyrës. Ceremonia filloi me parakalimin e Gardës së Nderit të Policisë së Kosovës, duke vazhduar me nderimin e himnit shtetëror të Kosovës nga të



pranishmit.

Në fjalimin e mbajtur në këtë ceremoni, ministri i Punëve të Brendshme shprehu përkushtimin e vazhdueshëm të Qeverisë së Kosovës dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme për mbështetjen e më tutjeshme të Policisë së Kosovës në arritjen e misionit fisnik që ka Policia e Republikës së Kosovës, pra ruajtjen e jetës dhe pronës së çdo qytetari të Republikës së Kosovës.

Po ashtu, më tutje ministri i Punëve të Brendshme, Bajram Rexhepi ka pohuar se Policia e Kosovës është dëshmia më e mirë që Kosova mund të ndërtojë institucione të sigurisë dhe zbatimit të ligjit, të cilat garantojnë përfaqësimin afirmativ të komuniteteve pakicë dhe hapësirë të mjaftueshme për përfaqësim gjinor. Duke folur për punën 14 vjeçare të Policisë së Kosovës, Rexhepi ka potencuar se me këtë institucion është krenar çdo qytetar i vendit. Ndërsa ka shtuar se bartja e uniformës e institucionit i cili përkujdeset për të garantuar sigurinë dhe pronën e qytetarit, paraqet një nivel të lartë të përgjegjësisë ndaj shtetit dhe privilegji i tillë i takon çdo qytetari të vendit, i cili dëshmon se është i gatshëm t'i shërbejë Kosovës me dinjitet dhe nder.

"Policia e Kosovës gjithmonë ka qenë afër qytetarit dhe në shërbim të tij, madje edhe në atë pjesë të vendit ku vazhdimisht i është sfiduar autoriteti. Tanimë edhe në pjesën veriore të vendit po ven-

doset ligjshmëria. Po largohen paralelizmat dhe po iu ofrojmë rastin qytetarëve në atë pjesë të vendit të integrohen në Policinë e Kosovës. Misioni juaj i shenjtë i ruajtjes së lirisë, sigurisë, jetës dhe pronës së qytetarit, përveç që kërkon angazhim të vazhdueshëm ai ka edhe sfida të mëdha", ka pohuar ai.

Sipas ministrit Rexhepi, Policia e Kosovës gjatë këtyre 14 vjetëve ka qenë dhe vazhdon të mbesë shtylla më e fortë në luftimin e krimit të të gjitha llojeve në vend e në veçanti krimit të organizuar. Ai për gjithë këtë punë ka garantuar se Qeveria e Republikës së Kosovës do të vazhdojë të mbështesë me të gjitha kapacitetet e saj avancimin e më tutjeshëm të Policisë së Kosovës.

"Gjatë këtyre viteve të fundit, falë punës suaj, i kemi bërë të lehta vendimet, qoftë për rritjen e pagave, fillimin e procesit të gradimit, i cili padrejtësisht ka qenë i ngrirë, duke pamundësuar ngritjen në karrierë dhe shërbim. Në këtë frymë ne po angazhohemi që sa më parë të kemi sigurimet shëndetësore për çdo zyrtar policor dhe brenda vitit do të nxjerrim edhe normativën ligjore për pensionimin e parakohshëm të zyrtarëve policorë. Gjithmonë me qëllim të rinimit të forcës sonë policore. Brenda pak ditësh ne do t'i nisim zyrtarët tanë ndërlidhës nga Policia e Kosovës në Gjermani, Francë, Belgjikë, Austri dhe Turqi, gjithnjë me qëllim forcimin e bashkëpunimit me

vendet tona mike", ka pohuar ai. Ndërsa, drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Shpend Maxhuni, në fjalën e rastit në këtë ceremoni përmes një rezymeje të punës 14 vjeçare, ka rikujtuar se rrugëtimi nga themelimi e deri në këtë ditë nuk ka qenë i lehtë, ka qenë me shumë sfida, por njëkohësisht ka shpalosur edhe vendosmërinë e secilit pjesëtar të Policisë së Kosovës që të pathyeshëm dhe krenar kanë tejkaluar të gjitha sfidat, duke arritur besimin e qytetarëve si një parakusht qenësor për të realizuar me sukses misionin tonë policor. Ai ka potencuar se falë këtij përkushtimi në disa



POLICIA E KOSOVËS POLICIJA KOSOVA



raste edhe deri në vetëflim në kryerje të detyrës, Policia e Kosovës ka arritur të bëhet ndër policitë më moderne në rajon, duke u krahasuar edhe me policitë e vendeve që kanë traditë më të gjatë në policim.

U bënë 14 vjet që kur Kosova vuri themelet e një kalaje të madhe, Policisë së Kosovës, e cila për këto 14 vjet u ngrit dhe u aftësua me standardet më të avancuara demokratike, për të ofruar rend dhe siguri për qytetarët, si nevojë fundamentale për një jetë me prosperitet.

Falë punës së palodhshme, mbështetjes së qeverisë së vendit dhe partnerëve

ndërkombëtarë strategjikë, sot jemi një nga policitë më moderne në rajon, si një faktor sigurie jo vetëm për Kosovën e rajonin, por edhe më gjerë. Rezultatet e arritura në luftën kundër krimit të organizuar, korrupsionit, trafikëve të ndryshme dhe formave tjera të krimit, janë dëshmia më e mirë dhe garancia që ofron Policia e Kosovës, në bashkëpunim me institucionet tjera për të arritur proceset tjera integruese që synon Kosova, ka pohuar ai. Formimi i një institucioni të sigurisë në një vend të dalë nga lufta nuk ishte i lehtë, prandaj në këtë kontest z. Maxhuni shtoi: "Gjatë rrugëtimit tanë u sfiduar në forma të ndryshme, por të pathyeshëm dhe krenarë tejkaluam të gjitha sfidat, duke arritur të fitojmë besimin e qytetarëve si një parakusht qenësor për të realizuar me sukses misionin tonë. Përkushtimi i secilit pjesëtar të Policisë së Kosovës duke mos kursyer as jetën e vet, meriton lëvdatë, sepse me punën e tyre, profesionalizmin, sakrificën dhe guximin, po i dalin të keqes përpara në mënyrë që qytetarët e Kosovës të jetojnë të sigurt, me dinjitet dhe pa brengën e frikës. 14 policë të Kosovës, të patrembur dhe guximtarë, dhanë edhe jetën në krye të detyrës së shenjtë që Policia e Kosovës ka. Sot, Policia e Kosovës në shpirtin dhe mendjen e qytetarëve, është sinonim i sigurisë, rendit dhe mbështetjes kundër çfarëdo tendence për të cenuar sigurinë e tyre. Me një vizion të kthjellët

dhe ambicie të pastra, të mbështetur në vlerat, idealet dhe parimet demokratike, me një punë me ngulm dhe të paepr, Policia e Kosovës do të vazhdojë të angazhohet për të qenë profesionale, e zhvilluar dhe moderne, drejt përmbyshjes së synimeve dhe objektivave bashkëkohore në luftë të pa kompromis kundër të gjitha formave të krimit", tha z. Maxhuni. Siç është bërë edhe traditë, për nder të ditës së formimit të Policisë së Kosovës në këtë ceremoni janë ndarë edhe medalje dhe lëvdata për zyrtarët policorë të dalluar gjatë këtij viti.

Tre zyrtarë policorë nga DRP-Ferizaj, konkretisht rreshter Naim Rexha, zyrtarët policorë Mithat Hysiqi dhe Osman Gashi, janë nderuar me medaljen për 'shpëtim jete'.

Majorja e Policisë së Kosovës nga Divizioni i Trajnimeve znj. Olga Stefanovic është nderuar me medalje për shërbim të dalluar, ndërsa nga Departamenti i Operacioneve nënkolonel Musli Kololli me medalje policore për 'lëvdim'.

Nga Divizioni i Njërive të Specializuara janë dekoruar shtatë zyrtarë policorë nga njësi të ndryshme. Kapiten Drazo Bozovic dhe zyrtarët policorë Erxhan Vitaku dhe Afrim Kastrati me medalje policore për 'lëvdim', ndërsa major Çlirim Hajdini, kapiten Alban Jetullahu, rreshter Besart Ahmeti dhe zyrtari policor Rober Musa janë dekoruar me certifikatë 'lëvdatë'.

Zyrtari policor Fidan Maliqi është nderuar me medalje policore për 'lëvdim' ndërsa Merita Demi, Jeton Sahiti dhe Premton Ejupi me certifikatë 'lëvdatë' që të gjithë nga Departamenti për Hetimin e Krimit. Nga Drejtoria Rajonale e Prishtinës zyrtari policor Lavdim Tahiri është nderuar me medalje policore për 'lëvdim'.

Në kuadër të programit të përgatitur për kremtimin e ditës së Policisë për të pranishmit është shfaqur një dokumentar ku u paraqit zhvillimi i Policisë së Kosovës dhe arritjet për këto 14 vjet.

Policia e Kosovës është themeluar me 6 shtator 1999, ku gjenerata e parë e kadeteve të Policisë së Kosovës kishte në përbërje gjithsej 176 kadetë. Kjo gjeneratë filloi trajnimin në Akademinë për Siguri Publike në Vushtri dhe që nga ajo kohë e deri më tani kanë diplomuar dhjetëra gjenerata të zyrtarëve policorë, duke plotësuar nevojat operacionale për zyrtarë policorë në gjithë territorin e vendit.

Përgatiti: Brahim Sadriu





PËRKUJTOHET HEROI I KOSOVËS ENVER ZYMBERI

Me rastin e përvjetorit të dytë të rënies së heroit të Kosovës, Enver Zymberi, pjesëtarit të një-sive speciale të Policisë së Kosovës, nën patronatin e kryeministrit të Republikës së Kosovës z. Hashim Thaçi në Sallën e Kuqe në Pallatin e Rinisë në Prishtinë, është mbajtur akademi përkujtimore. Në këtë akademi përkujtimore u vlerësua lart puna dhe përkushtimi, sakrificat e policit të rënë në detyrë, Enver Zymeri, për vënien e rendit dhe ligjit në tërë territorin e Republikë së Kosovës, duke kujtuar se Enveri do të mbahet mend, në historinë më të re të Kosovës, për guximin, dashurinë, përkushtimin dhe vullnetin për ndërtimin e shtetit demokratik.

Duke folur para të pranishmëve, familjarëve dhe pjesëmarrësve të tjerë në këtë akademi përkujtimore, kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi, tha se dy vjet më parë Kosova nisi një kapitull

**Me homazhe tek
varri, vizita te familja
dhe me një akademi
përkujtimore, u kujtua
dhe u nderua në
dyvjetorin e rënies,
pjesëtari i Njësisë
Speciale Operative të
Policisë së Kosovës,
Enver Zymberi**

të ri në shtrirjen e sovranitetit dhe mbrojtjen e integritetit territorial. Akcionin e organizuar në veri të vendit ai e arsyetoi me faktin se edhe 12 vjet pas luftës Kosova nuk po arrinte ta shtrijë në tërë territorin e saj sovranitetin për shkak të veprimit të strukturave ilegale serbe që nuk njihnin forcat legjitime të Kosovës.

Sipas kryeministrit Thaçi, Qeveria e Kosovës nuk mund të rrinte duarkryq në kohën kur strukturat jolegjitime dhe kriminale të vepronin dhe të thellonin pushtetin e tyre jolegjitim.

Data 25 korrik 2011 është dita e bashkimit të Kosovës, ndërsa Enver Zymberi është hero i bashkimit të Kosovës, prandaj ne sot duhet të ndihemi krenarë me heroizmin e Enver Zymberit dhe të gjithë atyre që sakrifkuan për shtetndërtimin, konsolidimin e Kosovës, tha ndër të tjera Thaçi në këtë akademi përkujtimore.



Me fjalën e tij drejtuar të pranishmëve, ministri i Punëve të Brendshme, Bajram Rexhepi, theksoi se hero i Kosovës, Enver Zymberi, ka lënë një gjurmë të pashlyer në historinë e re të Kosovës. Sipas tij, Enveri Zymberi bëri që rendi dhe sundimi i ligjit të funksionojë në tërë territorin e Republikës së Kosovës. "Enveri do të mbahet mend në historinë

e re të Kosovës për guximin, dashurinë, përkushtimin dhe vullnetin për ndërtimin e shtetit demokratik, shtetit në të cilin betohen të gjithë për sundim të rendit dhe ligjit. Ai ra në krye të detyrës së shenjtë të zbatuesit të ligjit, në betejën për të ruajtur rendin kushtetues dhe për të zbatuar ligjin në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Shëmbëlltira njerëzore e Enver Zymberit, heroit të Kosovës dhe përkushtimi i tij profesional për përmbushjen e detyrës, do të kujtohet me mburrje dhe nderim, por gjithmonë si shembull i sakrificës nga të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës", ka thënë ministri Rexhepi.

Ndërsa, drejtori i Policisë së Kosovës, Shpend Maxhuni, duke vlerësuar lart guximin dhe sakrificën e heroit Enver Zymberi, tha se Enveri ra heroikisht në detyrë, duke përmbushur me nder dhe

krenari misionin e besuar shtetëror, ai do të jetë frymëzim edhe për të gjithë pjesëtarët e Policisë për të shërbyer në mënyrë të dinjitetshme për qytetarët dhe shtetin e Kosovës.

"Vepra e Enver Zymerit, heroit të Kosovës, është një heroizëm i llojit të vet, për të përmbushur me nder dhe krenari misionin e besuar shtetëror.



Heroizmi i shfaqur me dinjitet të lartë qytetar do të mbetet përherë në historinë Kosovës. As dorasit e as dorëkëqijtë e Kosovës nuk do të na ndalin e as nuk do të pengojnë Policinë e Kosovës në përmbushjen e detyrave të shen-

jta para qytetarëve të saj. Të kota janë përpjekjet e përgjegjësve, për t'i ikur drejtësisë herët a vonë ata do ballafaqohen me drejtësi. Policia e Kosovës duke ndjekur vizionet dhe objektivat, por edhe amanetin e Enver Zymerit do të vazhdojë që me krenari, ndershmëri dhe profesionalizëm dhe guxim të ofrojë siguri për qytetarët e saj", ka thënë

Maxhuni.

Në emër të familjes, me një fjalë rasti, të pranishmit i ka përshëndetur, Egzon Zymberi, vël-lai i heroit Enver Zymeri, i cili shpalosi një dëshirë për të ardhmen e veriut të vendit.

"Kam shpresë dhe bindje se përvjetorët tjerë do t'i shënojmë me Mitrovicën e bashkuar. Qoftë i përhershëm kujtimi për martirët dhe heronjtë e Republikës së Kosovës", ka thënë Egzon Zymberi.

Enver Zymberi ish pjesëtar i njëjseve speciale të Policisë së Kosovës në Drejtorinë Ra-

jonale në Mitrovicë ra në krye të detyrës si zbatues i ligjit, në operacionin policor për ruajtjen dhe shtrirjen e rendin kushtetues dhe për zbatimin e ligjit në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Përgatiti: Baki Kelani

PUNA E NJË POL

Puna e patrullës përbën shpirtin kom

Që nga marrja e detyrave e deri tek kthimi në shtëpi janë detyrat dhe përgjegjësitë e një polici që bën punën e patrullës. Këto janë elemente përbërëse të zyrtarit policor duke u koordinuar me aftësinë për komunikim dhe raportimi për të gjitha problemet nga ana e qytetarëve tek njësitë patrulluese e që këto të fundit ballafaqohen direkt nga marrja e informatës për problemet që janë të pranishme e që me punë dhe profesionalizëm japin rezultate në luftimin dhe parandalimin e të gjitha llojeve të krimit.

Ky konkretizim parasheh edhe afërsinë më të madhe të policit patrullues me qytetarin. Jo gjithmonë gjërat shkojnë ashtu siç përshihen në plan duke pasur parasysh sfidat që mund të shfaqen në çdo kohë. Ecuria e kësaj vazhdon me përkushtimin që zyrtari patrullues vazhdon me këmbëngulje në realizimin e planit ditor në zbatimin e detyrave dhe përgjegjësi të ngarkuara me ligj.

Puna e patrullës përbën shpirtin komunikues në mes të policit dhe qytetarit, lidh shumë segmente dhe bashkon shumë drejtëza të cilat kanë marrë drejtim të gabuar. Në situata të tilla kur polici patrullues reagon me kohë qytetari ndihet më rehat dhe ajo çfarë është bërë, është kryer një detyrë dhe një mision që i është besuar në shoqëri. E drejta për të marrë vendime përpos që është e përcaktuar me ligj se çka është e drejtë dhe gabim ajo në shumë situata varet nga vendimet e marra individuale, veprat kriminale nuk duhet të kenë tolerime por edhe shoqëria ballafaqohet me probleme me të cilat nuk është ndeshur në të kaluarën.

Marrja e informatave, përgjigjja në raste të ndryshme kur qytetarët



kërkojnë ndihmën policore, zbatimin për mbarëvajtjen në trafikun publik, komunikimi me përfaqësuesit e bashkësisë, dhënia e ndihmës aq sa polici obligohet, evidentimin e personave të cilët gjinden në listën e të kërkuarve për krimet e bëra, ndihma në ekzekutimin e lëndëve gjyqësore dhe shumë detyra të tjera përbëjnë

listën e problemeve dhe detyrave që ngarkohet një zyrtar patrullues. Puna e shkëlqyeshme e një zyrtari patrullues ndihmon njësitë tjera policore të jenë më afër zgjidhjes së problemit nëse polici patrullues arrin të bëjë identifikimin e personave të cilët jetojnë në një bashkësi apo lagje dhe frekuentimin e personave të tjerë, atëherë polici krijon

ICI NË PATRULLË

unikues në mes të policit dhe qytetarit



një kartotekë personale që mund të shërbehet për mbarëvajtjen e punës së tij. Kjo kartotekë e të dhënave e ndihmon se çfarë duhet të veprojnë në të ardhmen në parandalimin e krimit dhe heqjen e maskës gjithë atyre personave që fshihen prapa saj. Puna e ngritur në sektorë ku një udhëheqës sektori është i pajisur me informata duke u nisur nga

numri i banorëve, objektet me rëndësi të veçantë, shkollat, objektet fetare dhe format e ushtrimit e religjionit në atë bashkësi apo komunitet, numri i dyqaneve dhe zejeve që ushtrohen, të dhënat për personat që kanë ndikim në rrethin dhe shoqërinë ku ata jetojnë, marrja e informatave për gjendjen sociale dhe ekonomike të bashkësisë

dhe shumë informata të tjera paraqesin doemos lehtësimin e policit patrullues në lagje dhe bashkësi. Organizimi shoqëror, niveli i edukimit dhe kushtet ekonomike të komunitetit ku polici shërben me nder dhe dinjitet, ndikon po ashtu edhe në punën e policit patrullues, disa forma të krimit të cilat shfaqen apo tentojnë të shfaqen në shoqëri polici patrullues mund t'i parandalojë duke i trajtuar me kohë si dhe duke raportuar problemet e komunitetit me kohë në stafin komandues policor por edhe institucione tjera, me qëllim që të merren masa të mëtutjeshme dhe vetëm kështu kur polici është aktiv atëherë e ardhmja është më e sigurt. Këto veprime pozitive të efektivës së policisë patrulluese mund të vërehen edhe në punën e sektorëve, sado që mbledhja e informatave nga policët në shikim të parë mund të duket si punë boshe por megjithatë ajo në të ardhmen jep frytet e saj pozitive. Shembulli i mirë kur polici ka njohuri në lagjen apo bashkësinë ku ai patrullon i dinë të gjitha problemet, pakënaqësitë me të cilat ballafaqohen qytetarët, duke u nisur nga infrastruktura dhe çështjet urbane, gjendja e rëndë ekonomike, të gjitha këto do të ndeshen në policin patrullues. Qytetari do të mendojë se edhe këto probleme janë probleme policore dhe që policia duhet t'i zgjidhë. Por mbi të gjitha polici patrullues i Policisë së Kosovës kryen shërbime me nder, përkushtim, profesionalizëm dhe mbi të gjitha e kryen detyrën me dinjitet, dhe falë të gjitha këtyre vetive pozitive është arritur që shumë krime janë zbuluar dhe parandaluar gjithmonë falë Policisë së Kosovës, falë angazhimit të njësive patrulluese dhe njësive tjera policore.

Mërgim Bektashi

DONACION PËR NJËSINË PËR HETIMIN E DHUNËS NË FAMILJE

Në një ceremoni të organizuar nga Policia e Kosovës në objektet e Policisë së Kosovës, ku kanë marrë pjesë përfaqësues nga MPB-ja, Policia e Kosovës, Prokuroria e Shtetit, UNDP-ja dhe Ambasada e Mbretërisë së Holandës në Kosovë është ndarë një donacion me pajisje të teknologjisë informative për Policinë e Kosovës dhe Prokurorinë e Shtetit nga UNDP-ja dhe Ambasada e Mbretërisë së Holandës në Kosovë.

Qëllimi i këtij donacioni është që t'u ndihmohet institucioneve të shtetit të Kosovës, në këtë rast Policisë dhe Prokurorisë së Kosovës në ndërtimin e kapaciteteve në fushën e teknologjisë informative, në parandalimin dhe luftimin e rasteve të dhunës në familje.

Zëvendësudrejtori i përgjithshëm për Operativë i Policisë së Kosovës, z. Naim Rexha, në fjalën e tij ka falënderuar UNDP-në dhe Mbretërinë holandeze për financimin dhe mbështetjen e këtij projekti si ndihmesë për Policinë e Ko-

Qëllimi i këtij donacioni është që t'u ndihmohet institucioneve të shtetit të Kosovës, në këtë rast Policisë dhe Prokurorisë së Kosovës në ndërtimin e kapaciteteve në fushën e teknologjisë informative, në parandalimin dhe luftimin e rasteve të dhunës në familje

sovës dhe Njësitin për Mbrojtje dhe Përkrahje të Viktimave.

Puna e vazhdueshme e zyrtarëve policorë por edhe mbështetja me pajisje të teknologjisë informative, ka bërë që rastet e dhunës në familje, krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit 2012 kanë shënuar rënie theksoi z. Rexha.

Në fjalën e tij z. Driton Gashi, sekretar permanent në Ministrinë e Punëve të Brendshme të Kosovës ka vlerësuar ndihmën dhe mbështetjen që institucionet ndërkombëtare, në ras-





tin konkret UNDP-në dhe Ambasadën e Mbretërisë së Holandës në Kosovë për institucionet e Kosovës, e në rastin konkret Policisë dhe Prokurorisë e njëkohësisht ai ka shprehur mbështetjen e vazhdueshme që ka MBP-ja në drejtim të Policisë së Kosovës në luftimin e të gjitha kategorive të krimeve në vend. Nga Prokuroria e Shtetit znj. Laura Pula, prokurore e Prokurorisë së Apelit nga Prokuroria e Shtetit, ka vlerësuar se ky donacion do të lehtësojë punën në zbulimin e veprave penale dhe viktimave do t'u japë një përkrahje më të

madhe. Carel Brands, përfaqësues nga Ambasada e Mbretërisë së Holandës në Kosovë, ka pohuar se dhuna në familje është problem global dhe se sipas tij, gratë janë viktimë e dhunës edhe në vendin e tij, por edhe në shtetet e tjera të botës.

Realizimi i këtij projekti është kryer falë bashkëpunimit që Policia e Kosovës, në rastin konkret Njësia për Hetimin e rasteve të Dhunës në Familje dhe abuzimit me të mitur me UNDP-në dhe institucionet tjera.

Donacioni për Policinë e Kosovës

përfshin: 43 kompjuterë, 1 laptop, 1 projektor, 6 aparate fotokopjuese, 1 printer dhe 1 skaner, ndërsa mbështetja për sistemin e drejtësisë, përkatësisht Prokurorisë së Shtetit është: 5 kompjuterë, 20 kamera dhe 20 diktafona.

Në fund të këtij solemniteti u bë edhe pranim-dorëzimi i këtij donacioni, ndërsa u premtua se ndihma të tilla, për të ndihmuar luftën kundër dhunës në familje, do të vazhdojnë edhe në të ardhmen.

Përgatiti: Brahim Sadriu

OPERACIONE

DISA NGA OPERACIONET E SUKSESSHME TË VITIT 2013 NG

OPERACIONI POLICOR "KUMBARA" ARRESTON NJË TË DYSHUAR PËR 'KONTRABANDIM TË MIGRANTËVE', 'FALSIFIKIM TË DOKUMENTEVE' DHE 'MASHTRIM'

Njësia e Hetimeve, Departamenti i Policisë Kufitare, me 16.8.2013, ka bërë arrestimin e një personi të dyshuar, nën dyshimin e bazuar se i njëjti në bashkëpunim me një të dyshuar tjetër ka kryer veprën penale 'kontrabandim me migrantë', 'falsifikim të dokumenteve' dhe 'mashttrim'. Operacioni i koduar me emrin "KUMBARA" ka rezultuar me kontrollimin e dy shtëpive me objekte përcjellëse në fshatrat e komunës së Graçanicës, me ç'rast janë identifikuar dy të dyshuar, të cilët në vazhdimësi kryenin veprat penale të kontrabandimit të migrantëve dhe falsifikimin e dokumenteve të udhëtimit. Këta të dyshuar kanë bërë sigurimin dhe rregullimin e dokumenteve të ndryshme të udhëtimit, dokumente këto të falsifikuara për të dërguar persona në shtete të ndryshme të BE-së. Gjatë këtij operacioni janë gjetur dhe konfiskuar gjësende të ndryshme të cilat dëshmojnë përfshirjen e këtyre personave në veprimtari të tilla kriminale.

ARRESTOHEN KATËR PERSONA TË DYSHUAR PËR 'KONTRABANDIM ME MIGRANTË'

Policia e Kosovës, pas hetimeve të kryera disamujore lidhur me veprimtarinë kriminale të një grupi të personave për të cilët dyshohej se merreshin me kontrabandim me migrantë, me 23.8.2013 në rajonin e Gjilanit dhe të Podujevës, ka realizuar me operacionin policor të koduar me emrin "MLEQANI". Gjatë realizimit të këtij operacioni policor janë arrestuar katër persona që vepronin si grup, për të cilët ekziston dyshimi i bazuar se të njëjtit në vazhdimësi kryenin veprën penale të kontrabandimit të migrantëve, duke përfutur mjete financiare në mënyrë të kundërligjshme. Në kuadër të këtij operacioni janë identifikuar edhe gjashtë viktima të trafikimit me migrantë të cilët ishin përgatitur nga të dyshuarit që përmes rrugëve ilegale të shkonin në shtetet e BE-së, që për këtë shërbim kishin paguar nga 2000 euro për person. Ky operacion policor është realizuar në rajonin e Gjilanit, konkretisht në pikëkalimin kufitar te Dheu i Bardhë, ku janë arrestuar personat e dyshuar, ndërsa viktimat e kontrabandimit me migrantë janë ndaluar në pikëkalimin kufitar në Merdare. Bazuar në hetimet preliminare policore dyshohet se personat e dyshuar kishin planifikuar që ata të kalonin kufirin në pikëkalimin kufitar te Dheu i Bardhë, ndërsa viktimat në pikëkalimin



kufitar në Merdare, me qëllim që të takoheshin në Serbi për të vazhduar tutje për vendet perëndimore.

OPERACIONI "DUBRAVA" GODET GRUPIN KRIMINAL PËR 'KONTRABANDIM ME MIGRANTË' DHE 'KRIM TË ORGANIZUAR'

Në një operacion që ka realizuar Drejtoria për Hetimin e Krimit të Organizuar pas hetimeve të zhvilluara lidhur me veprimtarinë kriminale të një grupi të organizuar, i përbërë nga disa persona për të cilët dyshohej se merreshin me kontrabandim me migrantë- krim i organizuar, me 4.9.2013 në rajonin e Prizrenit në pesë lokacione të ndryshme, ka realizuar operacionin policor të koduar me emrin "DUBRAVA". Gjatë realizimit të këtij operacioni policor janë arrestuar pesë (5) persona shtetas kosovarë që vepronin si grup, për të cilët ekziston dyshimi i bazuar se të njëjtit në vazhdimësi kryenin veprën penale të kontrabandimit të migrantëve dhe falsifikimin e dokumenteve të udhëtimit, duke përfutur mjete financiare në mënyrë të kundërligjshme. Bazuar në hetimet policore ky grup personash të dyshuar me qëllim të përfutimit të shumave financiare, organizonin grupe dhe individë, qytetarë të Republikës së Kosovës, me qëllim të kontrabandimit të tyre në shtetet e perëndimit.

Gjatë hetimeve të këtij rasti deri më tani janë identifikuar 26 viktima të kontrabandimit me migrantë.

OPERACIONI POLICOR "ERENIKU" GODET GRUPIN KRIMINAL PËR 'KONTRABANDIM TË MIGRANTËVE' DHE 'KRIM TË ORGANIZUAR'

Drejtoria për Hetimin e Krimit të Organizuar nën udhëheqje të prokurorit publik pas hetimeve të kryera, lidhur me veprimtarinë kriminale të një grupi të organizuar që merrej me kontrabandim të migrantëve, krim të organizuar, me datën 23.7.2013 ka bërë arrestimin e tetë

OPERACIONI

A DEPARTAMENTI PËR HETIMIN E KRIMIT

personave të dyshuar nën dyshimin e bazuar se të njëjtit kanë kryer veprën penale 'kontrabandim me migrantë' dhe 'krim të organizuar'. Operacioni i koduar me emrin "ERENIKU", ka rezultuar me kontrollimin në gjashtë qytete të Kosovës: Prishtinë, Ferizaj, Shtime, Prizren, Rahovec dhe Pejë në gjithsej trembëdhjetë lokacione të ndryshme, me ç'rast është arrestuar grupi i të dyshuarve, të cilët në vazhdimësi kryenin veprat penale të kontrabandimit të migrantëve dhe falsifikimin e dokumenteve të udhëtimit. Gjatë këtij operacioni janë kontrolluar nëntë shtëpi dhe objekte përcjellëse si dhe katër agjensione turistike. Të dyshuarit me qëllim të përfitimit të shumave të mëdha financiare, organizonin grupe të qytetarëve të Republikës së Kosovës, me qëllim të kontrabandimit të tyre në shtetet e perëndimit. Gjatë hetimeve të këtij rasti janë identifikuar 30 viktima të kontrabandimit me migrantë.

OPERACIONI "VERA" GODET GRUPIN KRIMINAL PËR 'POSEDIM, SHPËRNDARJE TË PAAUTORIZUAR TË SUBSTANCËVE NARKOTIKE' DHE 'ARMËMBAJTJE PA LEJE'

Drejtorja për Hetimin e Trafikimit me Narkotikë ka realizuar operacionin e koduar "VERA" me ç'rast ka konfiskuar 4 kg 621g substancë narkotike të llojit Heroinë, 68.8g Kokainë dhe janë arrestuar pesë persona. Këtij operacioni policor i ka paraprirë një periudhë hetimore rreth tre muaj, me ç'rast me 5.9.2013 në rrugën Prishtinë-Fushë Kosovë, nga Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Narkotikë, hetuesit policorë fillimisht kanë ndaluar një veturë me targa vendore dhe gjatë kontrollimit të veturës janë gjetur gjashtë (8) qese të mbushura me substancë narkotike e dyshuar të jetë e llojit Heroinë.

Operacioni nuk është ndaluar me kaq dhe ka vazhduar në një lagje të Prishtinës, ku janë ndaluar edhe dy vetura tjera me targa vendore nën dyshimin e bazuar se të njëjtat janë duke bërë transportin e substancës narkotike dhe me këtë rast janë arrestuar dy persona, respektivisht vozitësit

e veturave. Operacioni policor ka vazhduar me kontrollin e një lokacioni tjetër në Prishtinë, me ç'rast janë gjetur edhe 68.8 g e dyshuar të jetë e llojit Kokainë. Substanca narkotike është sekuestruar ndërsa personave të dyshuar u është caktuar masa e ndalimit për 48 orë nga prokurori i Prokurorisë Themelore në Prishtinë.

ARRESTOHEN DY PERSONA TË DYSHUAR PËR 'MUNDËSIM OSE DETYRIM NË PROSTITUCION'

Drejtorja për Hetimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore me 4.9.2013 në rajonin e Prishtinës ka realizuar një operacion policor, me ç'rast ka arrestuar dy persona femra shqiptare-kosovare, me dyshimin e bazuar se të njëjtat kanë kryer veprën penale 'mundësim ose detyrim në prostitucion'. Bazuar në hetimet fillestare policore ekziston dyshimi i bazuar se të dyshuarat në bashkëveprim e kanë kryer veprën penale 'mundësim ose detyrim në prostitucion', duke i rekrutuar, ndihmuar dhe kontrolluar personat për qëllime të prostitucionit. Kjo veprimtari kriminale është kryer në një lokal që kishte për destinim ofrimin e shërbimeve të masazhit dhe në emër të shërbimeve të masazhit dyshohet që janë kryer edhe veprimtari të kundërligjshme, si 'mundësim ose detyrim në prostitucion'. Në këtë lokal dy të dyshuarat kanë qenë pronare dhe njëkohësisht menaxhere të lokalit.

ARRESTOHEN PESË PERSONA TË DYSHUAR PËR 'MUNDËSIM NË PROSTITUCION' DHE 'MARRJE ME PROSTITUCION'

Njësia për Hetimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore-Prizren, me (14.8.2013) po në këtë rajon ka realizuar një operacion policor, me ç'rast ka arrestuar pesë persona me dyshimin se të njëjtit kanë kryer veprën penale 'mundësim në prostitucion' dhe 'marrje me prostitucion'. Ky operacion policor është realizuar bazuar në informacionet që zyrtarët policorë kishin arritur t'i siguronin më herët përmes rrugëve taktiko-operative lidhur me zhvillimin e këtij aktiviteti kriminal të këtij grupi. Bazuar në hetimet preliminare të policisë dy nga të dyshuarit në bashkëpunim kishin mundësuar zhvillimin e prostitucionit, duke shfrytëzuar një shtëpi dhe një lokal që dyshohet se u takojnë këtyre personave, me autorizim të prokurorit përkatës dhe ndaj dy personave është caktuar masa e ndalimit për 48 orë, ndërsa tre të tjerët janë dërguar në Gjykatë për Kundërvajtje për procedurë të mëturjeshme.





POLICËT E ARDHSHËM

Në kuadër të implementimit të planit policor 'Fillimi i vitit të ri shkollor' që realizohet nga zyrtarët policorë të Divizionit të Komunikacionit Rrugor dhe Drejtoria për Policim në Bashkësi dhe Preventivë edhe këtë shtator janë zhvilluar aktivitete të shumta që kanë për qëllim informimin e nxënësve lidhur me sigurinë në komunikacionin rrugor. Ky plan policor është i ndarë në tri faza, si: faza e identifikimit të zonave ku ka më shumë rrezikshmëri si pasojë e mungesës së shenjave të komunikacionit rrugor apo frekuentimit të madh të makinave dhe këmbësorëve, faza e dytë që përfshin ligjërimin nëpër

shkolla, ku nxënësit njoftohen me rregullat e komunikacionit rrugor dhe rreziqet në komunikacion dhe faza e tretë puna praktike me nxënës në rrugë.

Kjo praktikë realizohet në të gjitha stacionet policore ku nxënës të shkollave fillore, të shoqëruar nga policë të komunikacionit dhe policë të komunitetit, dalin dhe merren bashkërisht me rregullimin e trafikut rrugëve të vendit.

Edhe pse të vegjël, ata duken vërtet si policë të trafikut. Me "Stop" në dorë dhe jelekun fluoreshent e kapelën me shenjat "Police", ata zbatojnë ligjin, duke rregulluar trafikon rrugëve të

ndryshme në vend. Një aktivitet i tillë është realizuar edhe me 24.9.2013 me nxënës të klasës së VI të shkollës fillore "Ismail Qemali" në Prishtinë. Puna me fëmijët në terren është më shumë përgjegjësi dhe shumë atraktive njëkohësisht, thonë policët që janë në zbatim të këtij plani policor.

Ndërkohë, fëmijët shprehen të lumtur në uniformën e policisë së shtetit, ku ata po rriten dhe njëkohësisht shprehen plot gaz dhe hare se sot do t'jua "nxjerrim hakun disa shoferëve që nuk na japin përparësi as në kalimet e këmbësorëve".

Fillimisht këtyre fëmijëve zyrtarët policorë u japin informacione se si



duhet të ndalen makinat, si duhet të flitet me vozitësit pa harruar asnjëherë sigurinë e tyre gjatë punës. Vazhdimisht të shoqëruar nga policët e trafikut nxënësit kanë demonstruar praktikisht njohuritë që ata kanë fituar nga shkolla apo nga ligjëratat që kanë mbajtur zyrtarët policorë për sigurinë në komunikacionin rrugor.

Qëllimi kryesor i këtij plani policor është që fëmijët duke qenë e ardhmja e vendit të marrin informacione për kulturën në fushën e komunikacionit që duhet ta kenë kur të bëhen pjesë e komunikacionit, qoftë si këmbësorë apo qoftë edhe si shoferë, kur të rriten.

Ky aktivitet tanimë është bërë tradicional dhe po realizohet në bashkëpunim me shkolla. Ky projekt çdo vit implementohet nga Drejtoria e Policimit në Bashkësi dhe Preventivë, dhe nga zyrtarët e Divizionit për Komunikacion Rrugor.

Një aktivitet i tillë ndikon në përafrimin e policisë me komunitetin, krijimin e urave të bashkëpunimit, edukimin e brezave të ardhëm për siguri në komunikacionin rrugor, por gjithashtu ndikon edhe tek shoferët të mendojnë pak më kthjellët se shtatori është koha kur hapen shkollat dhe të kenë kujdes të shtuar gjatë vozitjes nëpër vendbanime, si dhe në afërsi të shkollave.

Edukimi i drejtë i brezit të ardhshëm është obligim i secilit prej nesh, prandaj edhe PK-ja duhet që të ndërmarrë sa më shumë aktivitete të tilla që janë në shërbim të komunitetit, e sidomos fëmijëve të cilët pa e ditur mirë se çka në të vërtetë është puna e policit shprehin dëshirën për t'u bërë policë kur të rriten, pse jo, ata mund të jenë disa që do të na zëvendësojnë ne në të ardhmen.

Brahim Sadriu



XHAXHI POLIC


Këngëtarja tashmë e njohur për fëmijë 10 vjeçarja Ilirida Berisha ka vendosur që një nga këngët e saj t'ia kushtojë punës së pjesëtarëve të Policisë së Kosovës. Me këngën e titulluar "Xhaxhi polic" ajo ka konkurruar në festivalin për fëmijë "Zogjtë e planetit" në Gjilan, ku është shpërblyer me çmim të dytë. Teksti i këngës edhe pse është i shkruar për botën fëmijërore ai në vete ngërthen disa mesazhe për bashkëmoshatarët e saj, si të sillen në rrugë dhe se çka punojnë pjesëtarët e policisë. Duke i uruar shëndet dhe jetë të gjatë Iliridës i urojmë sukses edhe në të ardhmen.

Xhaxhi polic

*Kur fëmijët flenë
Dhe unë ëndërroj
Vetëm ti nuk fle
Ti neve na mbron
Nëpër rrugët e qytetit
Kur diçka dëgjojmë
Fiu fiu fiu
Xhaxhi polic vrapon
Kur në shkollë ne shkojmë
Rrugën e kalojmë
Me dorëza të bardha
Ti neve na mbron
Nëpër rrugët e qytetit
Kur diçka dëgjojmë
Fiu fiu fiu
Xhaxhi polic vrapon*



KURIOZITETE



71 vjet me orën e gabuar

“Prej 71 vitesh, Spanja ka qenë pjesë e një zone orari të gabuar”. Ky është përfundimi i hetimit të një komisioni parlamentar në vend që propozon ndryshimin e zonës orar në të cilën vendi iberik duhet të bëjë pjesë. Deputetët spanjollë po shqyrtojnë seriozisht këtë kërkesë, që sipas raportit të komisionit do të përmirësojë ngrënien, gjumin dhe punën për spanjollët duke i bërë ata më produktivë.

“Ne flemë një orë më pak nga sa rekomandon Organizata Botërore e Shëndetësisë dhe gjithë kjo ka ndikim negativ në prodhim, rrit stresin, aksidentet dhe braktisjen e shkollave nga të rinjtë dhe fëmijët”, thuhet në raportin e Komisionit që shton se duke ndjekur orën e gabuar, spanjollët hanë, lënë punën dhe shkojnë në shtrat më vonë se fqinjët e tyre europianë. Raporti thotë se Spanja duhet t'i bashkohet sistemit orar të Britanisë së Madhe dhe Portugalisë.

Spanja është e vendosur me orën e Europës Qendrore që në vitin 1942, kur diktatori Gjenerali Franko e vendosi për të ndjekur Gjermaninë naziste.

Në çdo 2 minuta një i huaj merr pasaportën në Britani

Sipas të dhënave zyrtare në Britani mësohet që nga viti 2000 e deri më sot nga shteti britanik u është dhënë shtetësia dhe pasaporta britanike më shumë se 2 milionë të huajve dhe emigrantëve. Sipas këtyre shifrave i bie që një i huaj ose emigrant është bërë shtetas britanik në çdo 2 minuta e gjysmë, çka përbën ritmin më të lartë të dhënies së shtetësisë në historinë e këtij vendi. Me marrjen e shtetësisë britanike, shtetasit e rinj trajtohen si çdo vendas dhe kanë të njëjtin akses për ndihmat sociale për strehimin apo në tregun e punës. Sir Andrew Green, kryetari i organizatës “Migrationwatch” thotë se afro 4 milionë emigrantë të huaj kanë mbërritur në Britani që nga vitit 1998 dhe gjysma e tyre tashmë janë bërë shtetas britanikë. Këto shifra të Ministrisë së Brendshme, “Home

Office”, publikohen në një kohë kur konservatorët po hasin vështirësi për vënien nën kontroll të luftës kundër emigracionit. Nga këto shifra zyrtare kërkesat për shtetësi po miratohen më shpejt se në kulmin e politikës së dyerve të hapura të ish-qeverisë laburiste.



Gjen çantë me para, e dorëzon në polici

Një i pastrehë në Boston të Shteteve të Bashkuara të Amerikës ka gjetur një çantë me 42 mijë dollarë brenda... dhe e ka dorëzuar në polici.

Përveç shumës së parave, në çantë kishte edhe pasaportë e dokumente personale që i përkisnin një shtetasi kinez.

Policia e Bostonit ka bërë të ditur për “The Boston Herald” se burri që kreu këtë gjest të rrallë jeton në një qendër për të pastrehët. Çanta me shumën e parave dhe dokumentet e ndryshme i është kthyer pronarit.

Ferrari, makina për gratë police në Dubai



Në rrugët e Dubait, një makinë patrullës së policisë "Lamborghini", do ta ket krah për krah një "Ferrari" të ri të me ngjyrë të gjelbër dhe të bardhë. Makina e policisë,

ishte caktuar për gratë e brigadës që të patrullonin pjesën turistike të qytetit.

Pas dy javësh që është prezantuar "Lamborghini", është vendosur që gratë dhe

vajzat të ngasin "Ferrari" dhe këtë po e bëns, siç kanë thënë ata për të rritur "imazhin e luksit dhe prosperitetit" e emirate.

Kinë, polici i trafikut rrezikon jetën për të përmbushur detyrën

Një polic trafiku në Kinë ka rrezikuar jetën vetëm për të kontrolluar dokumentacionin e një taksie.

Polici i trafikut i ka kërkuar një taksie të ndalojë për t'i kontrolluar dokumentacionin, po drejtuesi i mjetit ka bërë të kundërtën. I ndodhur në këtë situatë, polici ka vendosur të hidhet në pjesën e përparme të autoveturës dhe ka qëndruar i varur aty. Ndërkohë, drejtuesi i mjetit në përpjekje për ta larguar, ka frenuar një moment duke zbritur nga automjeti dhe ka tërhequr policin. Por ky i fundit është hedhur sërish mbi automjet duke rrezikuar jetën e tij.

Këtë herë drejtuesi i mjetit nuk ka ndaluar, duke udhëtuar për disa kilometra me policin mbi makinë, derisa kapet nga policia. Drejtuesi i automjetit tani mund të përballet me dy akuza, që mund t'i kushtojë atij me vjet burg.



Polici që drejton trafikun duke...kërcyer

Profesioni i tij është ai i drejtimit të trafikut në një prej kryqëzimeve më të vështira të Johannesburgut, por ka një të veçantë. Ky polic quhet Kopi Leshabane, është 31 vjeç dhe profesioni i tij është ai i drejtimit të trafikut në një prej kryqëzimeve më të vështira të Johannesburgut. Mirëpo, veçantia qëndron në faktin se e ushtron punën e tij duke kërcyer, duke sjellë paksa gjallëri për ata që kalojnë aty në periudhat më të dendura të ditës. Ndërkohë që vetë ai thotë: "Mendoj se të gjithë duhet ta nisin ditën me buzëqeshje e gjallëri, prandaj këtë synoj të përcjell edhe unë".



FOTOLAJM



Pamje nga aktivitetet e Policisë me moton 'Thuaju jo substancave narkotike'




Punëtorja "Përcill paratë" bashkon të gjitha institucionet e zbatimit të ligjit



Ngjarje të pazakonta në autostradën e Kosovës

Autostrada nuk është për ahengje. Pamje nga ndalja e kolonës së dasmorëve në shiritin emergjent për të pushuar, për t'u mbledhur dhe për të bërë aheng, duke shfrytëzuar autostradën për vallëzim e argëtim.



Ngjarje të pazakonta në autostradën e Kosovës